**PLANI STRATEGJIK DHE POLITIKA E ZHVILLIMIT TË IKAP 2005– 2007**

## DEKLARATA E MISIONIT, OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE PERPARESITE

Te mbështesë zhvillimin e administratës publike për një shërbim civil profesional dhe të qëndrueshëm, nëpërmjet veprimtarive trajnuese cilësore dhe gjithëpërfshirëse. Instituti zyrtarisht u themelua me Udhëzimin Administrativ nr.2003/25 te datës 1 tetor 2003, te nënshkruar nga PSSP-ja.

## Qëllimet dhe Pikësynimet

Veprimtaria e IKAP për periudhën 2005 – 2007 do te përcaktohet nga gjashte objektivat e mëposhtëm strategjikë:

1. Hartimi dhe realizimi i programeve cilësore të trajnimit (tr. domosdoshme, standarde dhe speciale)
2. Zhvillimi dhe rritja e IKAP ne Qender Certifikuese per profesione te caktuara
3. Mësimi ne distance dhe e- trajnimi
4. Krijimi dhe vënia ne funksionim e bibliotekës se pajisur me libra dhe materiale studimore për trajnimin ne sh. civil
5. Zhvillimi i kapaciteteve të brendshme të IKAP
6. Zhvillimi i IKAP ne Qendër hulumtuese-zhvilluese

## Kriteret e matjes së suksesit

Arritjet e IKAP do të maten nga:

- Numri i përgjithshëm i të trajnuarve
- Numri i përgjithshëm i pjesëmarrjes se përsëritur te te trajnuarve, ministrive dhe komunave
- Niveli i përmbushjes se kërkesave te klientëve
- Përgatitja e programeve te trajnimit dhe materialeve për trajnim, doracakeve dhe librave

## PLANI STRATEGJIK DHE POLITIKA E ZHVILLIMIT te IKAP 2005– 2007

| Gjendja aktuale dhe ceshtjet kyqe | Qeverise,Objektivat dhe Politika | Veprimet Prioritare | Masat perfundimtare |
|---|---|---|---|
| 1. Hartimi dhe realizimi i programeve cilësore të trajnimit (tr.domosdoshme ,standarde dhe speciale) | 1.1 Hartimi dhe zhvillimi i kurseve të trajnimit të përshtatura ndaj nevojave të shërbimit civil, në përputhje me kerkesat bazike dhe me cilesine e standardeve ndërkombëtare të trajnimit | 1.1.1 Percaktimi i kompetencave, subjekteve të trajnimit, dhe veprimtarive qe i jane ngarkuar IKAP<br><br>1.1.2 Percaktimi i nevojave paresore per trajnimin dhe zhvillimin e sherbimit civil<br><br>1.1.3 Pergatitja, miratimi dhe aktualizimi i listes se programeve te trajnimit për periudhat 2005-2007 | • Percaktimi i nevojave paresore te trajnimit të administratës publike<br>• Hartimi i listës paraprake të temave të trajnimit të cilat do të realizohen nga IKAP<br>• Shqyrtimi i tyre në bashkëpunim me palet e interesuara (, ministritë dhe donatorët)nëpërmjet Bordit Këshillues<br>• Përgatitja e listës perfundimtare me programet paresore të trajnimit të cilat do të zhvillohen për herë të parë në periudhat 2004 –2005<br>• Caktimi i ekspertëve vendor dhe nderkombetar që do të bashkëpunojnë për hartimin, perpunimin dhe pergatitjen perfundimtare te kurseve, si dhe lidhja e kontratave me ta<br>• Përgatitja përfundimtare e materialeve bazë të kurseve te trajnimit, duke përfshirë edhe përkthimin cilësor të materialeve<br>• Trajnimi i trajnerëve të IKAP per zhvillimin me cilesi te kurseve të reja të trajnimit |
| | 1.2 Realizimi i një programi trajnimi gjithëpërfshirës për plotësimin e nevojave të shërbimit civil te Kosoves | 1.2.1 Menaxhimi i një spektri të gjerë programesh trajnimi(7 fusha gjenerike) | • Propagandimi i kurseve te trajnimit, hartimi i listave te pjesemarresve dhe sigurimi i kushteve te duhura per cdo kurs<br>• Zhvillimi i kurseve të trajnimit, duke përfshirë dhënien dhe regjistrimin e çertifikatave të pjesëmarrjes |
| | 1.3 Vlerësimi i trajnimeve te kryera dhe përmirësimi i vazhdueshëm i tyre | 1.3.1 Ndjekja e rezultateve të kurseve te trajnimit dhe vleresimi i plotesimit te kërkesave të pjesemarresve | Krijimi dhe mbajtja e një baze të kompjuterizuar të dhënash për pjesëmarrësit në kurse, si dhe per nivelin e permbushjes se kerkesave te tyre |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | 1.3.2 Vlerësimi i ndikimit te trajnimit ne punen e perditshme te te trajnuarve<br><br>1.3.3 Përsosja e hartimit dhe zhvillimit te kurseve te trajnimit në mënyrë që të garantohet permiresimi ne vazhdimesi | • Përgatitja, shpërndarja dhe analizimi i pyetësorëve për vlerësimin e kurseve nga pjesemarresit dhe nga ministritë<br><br>• Aktualizimi i vazhdueshëm i hartimit të kurseve, i materialeve të referencës dhe i metodologjisë së trajnimit |
| 2. Zhvillimi dhe rritja e IKAP ne Qender Certifikuese per profesione te caktuara<br>. | 2.1. Njohja e IKAP si Qendër e Akredituar Certifikuese ne fusha te caktuara te administrates publike me njohje nderkombetare<br><br>2.2.Trajnimet e zhvilluara ne IKAP ne kete segment te jene te barasvlereshme me piket adekuate(standard nderkombetar krahasimi) ne sistemin e ngritjes se vazhdueshme profesionale | 2.1.1. Ngritja e kapaciteteve teknike-profesionale brenda Institutit te pergatitur per bartjen e ketij procesi<br><br>2.1.2 Vendosja e marredhenieve te ndersjella me qendra akredituese per pranimin e IKAP si Qender Certifikuese per fusha te caktuara me njohje nderkombetare<br><br>2.1.3.Lidhja e kontratave me Qendrat Akredituese nderkombetare .<br><br>2.2 .1. Ngritja e kapaciteteve teknike-profesionale brenda Institutit te pergatitur per bartjen e ketij procesi<br><br>2.2.2. Bashkëpunimi me aktoret kryesor te shoqerise, ministritë dhe institucionet tjera, me qëllim që të mbështetet dhe pranohet ky aktivitet | • Identifikimi I fushave dhe profesioneve qe do te certifikohen nga IKAP ne përgjigje te nevojave të shprehura nga institucionet.<br><br>• Zhvillimi i kapaciteteve te brendshme njerezore per certifikim, por edhe angazhimi komplementar I eksperteve nga jashte ne rast te pamjaftueshmerise se ekspertizes ne IKAP.<br>• Studimi I tregut te punes dhe lidhja e nevojave per certifikim me kerkesat e tregut.<br><br>• Mbeshtetja e institucioneve per te zhvilluar dhe zbatuar planet e tyre te rekrutimit, si pjesemarres te drejtperdrejt ne sherbimin civil |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 3. Mesimi ne distance dhe e- trajnimi | 3.1.Organizimi i mesimit ne distance si edukim formal me njohje nderkombetare.<br><br>3.2.Organizimi i konferencave nderkombetare virtuale.<br><br>3.3.Zhvillimi i e-materialeve trajnuese ne fusha te ndryshme te administrates publike. | 3.1.1. Ngritja e kapaciteteve teknike-profesionale brenda Institutit te pergatitur per bartjen e ketij procesi(pajisje,menaxhim).<br>3.1.2. Bashkepunimi me institute simotra nderkombetare dhe universitete perendimore.<br><br>3.2.1.Organizimi i forumeve, Web-dizajneve, recensioneve, etj | • Zhvillimet e planprogrameve te e-trajnimit<br>• Pajisja me teknologji moderne komunikimi per mesim ne distance<br>• Dizajnimi i WEB-it per e-trajnime<br>• WEB - konsultimet<br>• Prodhimi dhe shperndarja e-materialeve<br>• Angazhimi I eksperteve nderkombetar me renome ne kete lemi si ligjerues, konsultant etj. |
| 4. Krijimi dhe venia ne funksionim e bibliotekes se pajisur me libra dhe materiale studimore per trajnimin ne sherbimin civil | 4.1 Mundësimi i përdorimit të (librave) njohurive dhe materialeve mesimore te perditesuara mbi menaxhimin e burimeve njerëzore dhe zhvillimin në shërbimin civil | 4.1.1 Pajisja, hapja dhe nxitja e librarisë së IKAP<br><br>4.1.2 Menaxhimi i funksionimit te bibliotekes se IKAP si nje biblioteke profesionale e mire-organizuar me orientim trajnimin dhe zhvillimin e shërbimit civil | • Identifikimi i materialeve mësimorë te parapelqyera dhe percaktimi i furnizuesve te tyre<br>• Prokurimi i materialeve mësimorë,(libra, manuale, CD Rom, video, etj<br>• Trajnimi i punonjeses se IKAP ne administrim bibliotekar për te siguruar perdorimin e lire dhe efektiv të fondit te bibliotekes.<br>• Promovimi i librarisë me anë të fletëpalosjeve, faqes në internet, etj, në përputhje me strategjinë e zhvillimit te IKAP<br>• Mbikqyrja dhe nxitja e përdorimit të bibliotekës<br>• Mirembajtja dhe aktualizimi i vazhdueshëm i fondit të bibliotekës |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 5. Zhvillimi i kapaciteteve të brendshme të IKAP | 5.1 Menaxhimi i IKAP si një institucion trajnimi modern, efikas, i orientuar drejt të ardhmes dhe ne funksion te përmbushjes së nevojave të administratës publike . | 5.1.1 Pajisja e IKAP me infrastrukturën e nevojshme për funksionim efektiv<br><br>5.1.2 Hartimi dhe zbatimi i politikave, procedurave dhe sistemeve që i mundësojnë IKAP arritjen e objektivave të tij<br><br>5.1.3 Garantimi brenda IKAP i nje ekipi pune te afte, te kualifikuar dhe te nxitur per te punuar<br><br>5.1.4 Mbajtja dhe zhvillimi i marrëdhënieve me institucionet homologe në rajon dhe ne mbare Evropën<br><br>5.1.5 Kontakte pune te mekanizmave qeveritar ne funksion te zbatimit te politikes se Qeverise | • Hartimi, zbatimi dhe ndjekja e një spektri të gjerë politikash, procedurash dhe sistemesh, ku përfshihen:<br>(a) menaxhimi i informacionit<br>(b) baza të dhënash për të trajnuarit, ministritë, kontaktet e brendshme, institucione homologe, trajneret vendas dhe nderkombetare, etj<br>(c) prokurimi i mallrave dhe i shërbimeve të konsulencës<br><br>• Mbajtja e mbledhjeve të rregullta të stafit<br>• Hartimi, miratimi dhe nënshkrimi i përshkrimeve të vendeve për punës për stafin e IKAP.<br>• Hartimi dhe perdorimi i një skeme për vlerësimin dhe zhvillimin e personelit<br><br>• Vendosja dhe mbajtja e kontakteve me institutet , rajonale dhe evropiane, pjesëmarrja në aktivititetet te perbashketa, shkëmbimi i përvojave dhe pjesëmarrja në programet zhvillimore |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 6. Zhvillimi i IKAP ne Qender hulumtuese-zhvilluese | 6.1.Ngritja e kapacitetit hulumtues-zhvillues te IKAP permes publikimit dhe vendosjeve te relacioneve me publikun.<br><br>6.2.Organizimi I konferencave e forumeve diskutuese ne sferen e zhvillimit te administrates publike. | 6.1.1.Publikimet shkencore ne fushen e administrates publike.<br><br>6.1.2. Botimi I revistes periodike ne fushen e zhvillimit te administrates publike.<br><br>6.1.3. Perkthimete te arriturave me te reja nderkombetare ne fushen e administrates publike.<br><br>6.2.1. Organizimi i konferencave me karakter vendor e nderkombetar per ceshtje te administrates publike.<br><br>6.2.2. Organizimi I forumeve diskutuese tematike ne fushen e zhvillimit dhe perparimit te administrates publike. | • Zhvillimi I kapacitetit te brendshem njerezor-intelektual te institutit , me zgjrdhje te kujdesshme te bartesve te ketij procesi, ne menyre qe te arrihen rezultatet e deshiruara.<br><br>• Pergatitja teknike e materialeve per publikim, duke pas parasysh permbajtjen , por edhe anen vizuele, duke bere nje marketing te mire.<br><br>• Sigurimi iI sherbimeve te perkthimit professional te literatures.<br><br>• Krijimi iI raporteve te hapura te komunikimit institucional , por edhe te autoriteteve individuale qe imponohen profesionalisht ne fushen e administrates Publike,qofte vendor apo nderkombetar.<br><br>• Menaxhimi pragmatic i organizimeve te konferencave e forumeve,duke shfrytezuar fondet me racionalitet optimal. |